



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No	05-8554
Nr.i faqeve Br.stranica No. pages	-17-
Data: Datum: Date:	28/12/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 231/XII/2023
Datë: 27.12.2023

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në Shtojcën 1, pika 6.1 Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

- I. Aprovohet plani i veprimit për pilotimin e sistemit të referimit elektronik nga kujdesi parësor shëndetësor në kujdesin dytësor shëndetësor 2024
- II. Shtojce e këtij vendimi është, plani i veprimit për pilotimin e sistemit të referimit elektronik nga kujdesi parësor shëndetësor në kujdesin dytësor shëndetësor 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Arben Vifia

Ministër i Shëndetësisë

Prishtinë / a

Vendim i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkiviot të MSh.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministry of Health - Ministarstvo Zdravstva

**PLANI I VEPRIMIT PËR PILOTIMIN E
SISTEMIT TË REFERIMIT ELEKTRONIK NGA
KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR NË
KUJDESIN DYTËSOR SHËNDETËSOR**

2024

Prishtinë, 2023

Versioni 1.0

Shkurtesat

IHS - Projekti "Shërbimet Shëndetësore të Integruara"

KPSH - Kujdesi Parësor Shëndetësor

KDSH - Kujdesi Dytësor Shëndetësor

KTSh - Kujdesi Tretësor Shëndetësor

MSh - Ministria e Shëndetësisë

PSO - Procedura Standarde Operative

QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

SISH - Sistemi Informativ Shëndetësor

SDC - Agjencia Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim

SP - Spital i Përgjithshëm

Swiss TPH - Instituti Zviceran për Shëndet Publik dhe Sëmundjet Tropikale

ShSKUK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

WHO - World Health Organization

PËRMBAJTJA

1. Hyrja	4
2. Qëllimi	5
3. Metodologjia	5
4. Sfondi	5
5. Monitorimi dhe raportimi.....	9
6. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i planit të veprimit	10

1. Hyrja

Hartimi i planit të veprimit për pilotimin e sistemit të referimit elektronik nga KPSH në KDSH është përpjekje e përbashkët dhe prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) me mbështetje të partnerit strategjik Projektit “Shërbimet Shëndetësore të Integruara” (IHS) projekt i financuar nga (Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim) SDC dhe zbatohet nga SWISS TPH (Instituti Zviceran për Shëndet Publik dhe Sëmundjet Tropikale). Plani i Veprimit do të përfshijë pilotimin e sistemit të referimit elektronik dhe caktimit të termineve nga Spitali i Përgjithshëm (SP) Pejë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Istog dhe anasjelltas. Plani i veprimit është hartuar nga grupi punues gjithëpërfshirës nga Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, Kujdesi Parësor Shëndetësor, Kujdesi Dytësor Shëndetësor) i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm me numër vendimi 05-7430 dt 17.11.2023.

Efikasiteti i çdo sistemi shëndetësor mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në aftësinë për të koordinuar kujdesin ndaj pacientit midis niveleve të ndryshme të ofruesve të kujdesit shëndetësor. Një aspekt kryesor i këtij koordinimi është sistemi i referimit, i cili lehtëson dhe i mundëson pacientit nga KPSH qasjen në shërbime shëndetësore të specializuara në KDSH dhe KTSH.

Sipas përkufizimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), “Referimi mund të përkufizohet si një proces në të cilin një punonjës në një nivel të sistemit shëndetësor, që ka burime të pamjaftueshme (barna, pajisje, aftësi, staf) për të menaxhuar një gjendje klinike, kërkon ndihmën e një institucioni më të mirë, apo me burime të ndryshme në të njëjtin nivel ose në një nivel më të lartë për të ndihmuar ose marrë përsipër menaxhimin e gjendjes së pacientit”.¹

Plani i veprimit ka qëllim përmirësimin e qasjes tradicionale të referimit duke shfrytëzuar zgjidhjet dixhitale dhe duke nxitur bashkëpunimin midis palëve të interesit që si objekt kryesor kanë thjeshtëzimin e procesit të referimit, caktimin e termineve, përmirësimin e qasjes së pacientëve në KDSH dhe rezultatet e përgjithshme në kujdesin shëndetësor si dhe kthimin e pacientëve në KPSH për të vazhduar trajtimin.

Poashtu Plani synon të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit shëndetësor duke adresuar një nga aspektet kyçe të kujdesit shëndetësor: sistemin e referimit dhe të caktimit të termineve. Për të arritur këtë qëllim, do të përdoret teknologjia digjitale dhe bashkëpunimi midis të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor me pacientin në qendër për të zhvilluar një sistem të avancuar të referimit. Nëpërmjet këtyre hapave, synohet të krijohet sistem më efikas duke përmirësuar kujdesin shëndetësor dhe ofruar shërbime shëndetësore cilësore në nivel vendi.

Dokumenti përmban pjesën narrative dhe pjesën tabelare ku definohet qartë rezultati me aktivitetet, nën aktivitetet, afatet kohore për zbatim të tyre në mënyrë të detajuar, kostoja e nevojshme për realizim, rolet specifike dhe përgjegjësia e Institucioneve udhëheqëse dhe

¹ WHO. Management of health facilities: Referral systems. World Health Organization. 2014 Google Scholar]

mbështetëse si dhe rezultatet e pritshme pas realizimit të aktiviteteve respektivisht nën aktiviteteve.

2. Qëllimi

Qëllimi i hartimit të Planit të Veprimit është zbatimi i rekomandimit nga raporti mbi hartimin e sistemit të pilotimit njëvjeçar të referimit mes niveleve parësor dhe dytësor. Plani përcakton qartë qëllimet dhe hapat e nevojshëm për funksionalizimin e sistemit të referimit elektronik dhe caktimit të termineve në mes SP Pejë dhe QKMF Istog dhe anasjelltas.

Poashtu plani do të ketë ndikim të drejtpërdrejt në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, qasjen ndaj sistemit shëndetësor, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, shkurtimi i kohës së pritjes së pacientëve si dhe do të përmirësojë dukshëm vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor të pacientit.

Me qëllim të funksionalizimit të procesit të referimit në mes të niveleve të kujdesit shëndetësor plani do të përcaktoj qartë aktivitetet dhe nën aktivitetet për menaxhimin e procesit të referimit elektronik dhe caktimit të termineve, koordinimin si dhe rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në procesin e referimit.

3. Metodologjia

Plani i veprimit lidhur me pilotimin e sistemit të referimit elektronik nga SP Pejë dhe QKMF Istog është hartuar duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit si dhe Manualit për hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

Poashtu dokumenti është hartuar në bazë të rekomandimeve pas analizës dhe përgatitjes së raportit mbi hartimin e sistemit të referimit elektronik mes nivelit parësor dhe dytësor. Nga të dhënat e siguruara nga raporti janë identifikuar sfidat në SP Pejë dhe QKMF Istog. Këto sfida janë të përafërta edhe në nivel vendi. Plani i veprimit do të zbatohet për periudhën e ardhshme një vjeçare gjatë vitit 2024, përderisa projeksionet e tjera do të bëhen varësisht nga situata e realizimit të aktiviteteve dhe nën aktiviteteve të caktuara në afate kohore.

4. Sfondi

Sistemi shëndetësor në Kosovë është i organizuar në tri nivele të kujdesit shëndetësor: kujdesi parësor, dytësor dhe tretësor. KPSH është pika e parë e kontaktit për pacientët dhe shërben si portë hyrëse në sistemin shëndetësor për të identifikuar dhe adresuar nevojat dhe shqetësimet e

pacientëve dhe për të siguruar një lidhje të mirëfilltë midis tyre dhe niveleve të tjera të sistemit shëndetësor.

Mënyra dhe llojet e referimit janë të përcaktuara bazuar në legjislacionin në fuqi, ku referimi bëhet nga mjeku familjar brenda KPSH si dhe referimi i jashtëm nga KPSH në KDSH dhe KTSh. Megjithatë në disa raste pacientët anashkalojnë KPSH dhe vetreferohen duke shkuar në institucionet e KDSH dhe KTSh gjë e cila shton numrin e pacientëve dhe ngarkesën në këto institucione.

Kjo dukuri ka pasoja duke përfshirë: koston e lartë për trajtimin, zvogëlimin e efikasitetit, rritjen e ngarkesës së sistemit shëndetësor dhe përfundon me shfrytëzim jo racional të shërbimeve shëndetësore. Prandaj, në mënyrë që të zvogëlohet ngarkesa në KDSH dhe KTSh dhe të sigurohet një përdorim më efikas i burimeve njerëzore përpjekjet janë të fokusuar në përmirësimin e sistemit aktual të referimit dhe edukimin e pacientëve, që ata të lajmërohen fillimisht në KPSH dhe në bazë të vlerësimit nga mjeku familjar referimi të bëhet në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor, ku pastaj pacienti sërish të kthehet në KPSH për trajtim të mëtuqjeshëm.

Duke u bazuar në Raportin e Progresit 2023 - Integrimi Evropian, Kosova ka sistemin e informacionit shëndetësor elektronik (e-shëndeti), bazuar në treguesit kryesorë evropianë të shëndetit, që mundëson komunikimin virtual ndërmjet përdoruesve/pacientëve dhe mjekëve të përgjithshëm, ofron shërbime këshillimi dhe nxjerrë të dhëna për pranimet, lirimet dhe transferimet e pacientëve. Megjithatë, ai nuk përdoret nga të gjitha institucionet shëndetësore dhe nuk përfshin funksionalitetet tjera (patologjinë, radiologjinë, transfuzionin e gjakut, dhe shërbime të tjera) që mbeten për t'u shtuar.²

Sistemi i referimit në Kosovë është i brishtë dhe ka nevojë të shëndrrohet në një sistem të zbatueshëm të referimit. Faktorët dhe konsideratat e zakonshme që ndikojnë në vendimin për të referuar një pacient janë: rastet komplekse, diagnoza e paqartë, ekspertiza e specializuar që është jashtë sferës së KPSH, procedurat dhe intervenimet specifike, kujdes i vazhdueshëm për sëmundjet kronike, urgjencat mjekësore, marrja e mendimit të dytë, komisionet vlerësuese, insistimi i pacientëve dhe familjarëve të tyre etj.

Hulumtimi i kryer nga ekspertët, i raportuar në vitin 2023 në regjionin evropian nga WHO, tregon qartë se nuk ka sistem të përsosur të referimit, por ekzistojnë mundësi në përmirësimin e kushteve (pajisjeve, mjekëve të specializuar në lëmi të ndryshme etj) për plotësimin e nevojave të pacientëve. Për të arritur këto përmirësime, rolet brenda sistemit duhet të qartësohen. Sipas këtij hulumtimi është paraqitur nevoja për mbikqyrje të sistemit të referimit nga niveli më i lartë drejtues i Sistemit të Informimit shëndetësor (SISh) dhe një bashkëpunim i ngushtë në mes profesionistëve në nivel parësor shëndetësor me specialistët klinikistë si dhe me pacientët për të ridizajnuar sistemin e referimit. Në këtë rast niveli më i lartë i SISh nis dhe promovon një sistem ndryshimi me rolin kyq të specialistëve klinikistë.³

² Raporti i Progresit – Integrimi Evropian (rks-gov.net)

³ <https://www.who.int/europe/publications/i/item/WHO-EURO-2023>

SWOT Analiza

<p>Përparësitë</p> <p>Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi UA Kujdesi Parësor Shëndetësor 04/2020 UA për bashkëpagesa Përkrahja e Projektit donatorë Rrjeti i shtrirë i IT Përdorimi i rregullt nga disa mjekë dhe institucione shëndetësore.</p>	<p>Mundësitë</p> <p>Përmirësimi i procesit të referimit përmes funksionalizimit të referimit elektronik Rritja e bashkëpunimit mes niveleve të ndryshme të kujdesit shëndetësor</p>
<p>Dobësitë</p> <p>Mungesa e regjistrimit të banorëve në KPSH UA për bashkëpagesa nuk zbatohet plotësisht Pamjaftueshmëria në shkëmbimin e informacionit ndërmjet mjekëve dhe specialistëve. Mungesa e trajnimeve adekuate</p>	<p>Rreziqet</p> <p>Mosfunksionimi i përgjithshëm i SISH-it në periudha të ngarkuara. Siguria e të dhënave Rezistenca ndaj ndryshimeve Mospërdorimi i SISH nga stafi</p>
<p>Mirëmbajtja jo e rregulltë e SISH</p>	

Fig 1. SWOT analiza e sistemit të referimit në Kosovë

Plani i Veprimit ka rezultatin “ Sistemi i referimit elektronik nga SP Pejë në QKMF Istog dhe anasjelltas i funksionalizuar”, ku për realizimin e tij do të ndërmerren aktivitetet dhe nënaktivitetet specifike për periudhën një vjeqare.

Aktivitetet që do të realizohen janë :

- a) Vlerësimi i përputhshmërisë teknike të SISH aktual me modulën e sistemit të referimit elektronik dhe të caktimit të termineve përmes një analize për të vlerësuar se si SISH aktual përputhet me nevojat dhe specifikat e reja teknike që do të kërkohen për funksionalizimin e sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve. Kjo do të realizohet përmes angazhimit të ekspertëve duke përshkruar në mënyrë të detajuar detyrat e tyre përmes hartimit të termave të referencës. Ekspertët do të vlerësojnë dhe analizojnë SISH aktual dhe

- përcaktojnë nevojat teknike dhe specifikat e reja të sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve.
- b) Hapat teknik të dizajnit, zhvillimit dhe vlerësimit të modulit të sistemit elektronik të referimit dhe sistemit të caktimit të termineve – do të përfshijnë identifikimin dhe sigurimin e pajisjeve harduerike (serverë, kompjuterë, pajisje periferike etj) që janë të nevojshme për zhvillimin, implementimin dhe funksionimin e modulit të sistemit të referimit dhe caktimit të termineve. Në këtë fazë do të fillojë dizajni, zhvillimi, testimi i modulit të referimit dhe caktimit të termineve për një modul funksional përmes zgjidhjeve software-ike ose aplikacioneve. Pas dizajnit dhe zhvillimit të modulit hapi i ardhshëm është instalimi dhe konfigurimi i tij në pajisjet e duhura. Më tutje është procesi i testimit të modulit për funksionalitetin e tij dhe për të zbuluar sfidat eventuale që tutje ato të adresohen.
 - c) Hartimi i udhëzuesit për përdorimin e modulit të sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve dhe trajnimi do të bëhet për të siguruar një sistem të referimit elektronik dhe caktimit të termineve efikas. Udhëzuesi do të jetë një dokument që do të përmban hapat dhe udhëzimet e nevojshme për përdorimin e sistemit nga personeli shëndetësor dhe administratorët e SISh në institucionet përkatëse të përfshira në pilotim. Pas hartimit të udhëzuesit do të hartohet plani i trajnimit ku do të trajnohen profesionistët shëndetësor, administratorët e SISh në SP Pejë dhe QKMF Istog si dhe Procedura Standarde Operative (PSO) për përdorimin e modulit.
 - d) Pilotimi i sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve është proces i rëndësishëm për të vlerësuar funksionimin dhe efektivitetin e këtij sistemi në praktikë në institucionet që do të përfshihen në pilotim. Kjo do të realizohet përmes takimeve me menaxhmentin e ShSKUK, SP Pejë dhe QKMF Istog ku do të diskutohet qëllimi i pilotimit, detajet e zbatimit, metodologjia e vlerësimit dhe monitorimit të procesit. Para fillimit të pilotimit, do të bëhet fushatë sensibilizuese në media lokale për vetëdijësimin e qytetarëve që do të përfshin: informimin e tyre për procedurat dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të referimit dhe caktimit të termineve. Pas takimeve në mes të menaxhmentit të lartë të niveleve të kujdesit shëndetësor dhe fushatës për vetëdijësim do të fillojë pilotimi në SP Pejë dhe QKMF Istog. Pra, zbatimi i sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve në praktikë, duke përfshirë përdorimin e tij nga profesionistët shëndetësor, administratorët e SISh dhe pacientët.
 - e) Monitorimi, vlerësimi dhe mirëmbajtja e sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve janë thelbësore për funksionim të qëndrueshëm dhe efikas të tij. Gjatë procesit të pilotimit do të realizohet anketa me anë të së cilës do të vlerësohet performanca, efektiviteti i sistemit të referimit dhe caktimit të termineve si dhe sfidat gjatë këtij procesi. Përpos anketës do të realizohet edhe intervista me përdoruesit e sistemit të referimit. Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së sistemit duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, vlerësimin e përgjithshëm të performancës së sistemit. Mirëmbajtja e sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve përfshin procedurat dhe veprimet e nevojshme për të ruajtur dhe përmirësuar funksionimin e sistemit përmes azhurnimeve të nevojshme teknike, rregullimin e gabimeve, menaxhimin e përdorimit të sistemit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së tij.

Më poshtë është e paraqitur grafikisht modeli i Sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve




Fig.2 Modeli i referimit elektronik dhe i caktimit të termineve

5. Monitorimi dhe raportimi

Institucioni udhëheqës për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit është Ministria e Shëndetësisë. Me qëllim të monitorimit të zbatimit të planit, është hartuar matrica e monitorimit dhe raportimit. Poashtu Sekretari i Përgjithshëm emëron Grupin punues për monitorimin e Planit të Veprimit pas aprovimit të tij. Korniza e monitorimit përmban rezultatin, aktivitetet dhe nën aktivitetet me afatin e zbatimit, bazën, cakun, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, gjendjen aktuale, Institucionin udhëheqës, Institucionin mbështetës si dhe pjesën e progresit dhe komenteve.

Realizimi i aktiviteteve për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Veprimit për pilotimin e sistemit të referimit elektronik dhe caktimit të termineve nga KPSH dhe KDSH 2024 do të mundësojnë sigurimin e të dhënave të bazuara në dëshmi lidhur me arritjen e rezultatit përmes aktiviteteve dhe nënaktiviteteve të përcaktuara në këtë plan.

Raportimi do të jetë periodik, me kohë të zbatimit të aktiviteteve, sfidave eventuale dhe rekomandimeve për ndryshime gjë që do të mundësojë adresimin e tyre në kohën e duhur. Qëllimi është orientimi i politikave drejt përmirësimit të vazhdueshëm të procesit të referimit në

mes të tri niveleve të kujdesit shëndetësor në nivel vendi, pas funksionalizimit të sistemit të referimit përmes pilotimit në SP Pejë dhe QKMF Istog.

6. Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i planit të veprimit

Aktivitetet dhe nën aktivitetet e Planit të Veprimit për pilotimin e sistemit të referimit elektronik dhe caktimit të termineve nga KPSH dhe KDSH 2024 do të përkrahet nga Projekti “Shërbimet Shëndetësore të Integruara” (IHS), projekt i financuara nga SDC dhe i zbatuar nga SWISS TPH. Këto aktivitete dhe nën aktivitete do të kryhen gjatë procesit të pilotimit njëvjeçar në SP Pejë dhe QKMF Istog. Zbatimi i Planit të Veprimit do të bëhet nga MSh si Institucion udhëheqës, ShSKUK, SP Pejë, QKMF Istog dhe projekti IHS.

Kostoja totale e Planit të Veprimit për pilotimin e sistemit të referimit elektronik dhe caktimit të termineve nga KPSH në KDSH 2024, është konfirmuar edhe nga grupi punues për kostimin e politikave në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Zbatimi i aktiviteteve financiare të këtij plani do të monitorohet dhe raportohet në baza të rregullta. Kostoja totale e Planit të Veprimit ka vlerën: 328.000.00 €

PLANI I VEPRIMIT

**PLANI I VEPRIMIT PËR PILOTIMIN E SISTEMIT TË REFERIMIT ELEKTRONIK NGA KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR
NË KUJDEsin DYTËSOR SHËNDETËSOR**

2024

REZULTATI 1

Sistemi i referimit elektronik nga Spitali i përgjithshëm Pejë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Istog dhe anasjelltas i funksionalizuar

Aktiviteti 1	Afati i zbatimit	Kostoja totale		Burim i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1					
1.1. Vlerësimi i funksionalitetit të SISH për të përcaktuar specifikacionet teknike të kërkuara për funksionalizim të sistemit të referimit dhe të caktimit të termineve	TM1 2024	50.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, SP Pejë, QKMF Istog, IHS	Specifikacionet teknike për funksionalizim të sistemit të referimit dhe caktimit të termineve të hartuara
Nën aktivitetet							
1.1.1. Hartimi i termave të referencës për ekspertët	TM1 2024	10.000 €		IHS	MSh	MSh, ShSKUK, IHS	Termat e referencës të hartuara
1.1.2. Vlerësimi i specifikacioneve teknike	TM1 2024	10.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASH, SP Pejë, QKMF Istog, IHS	Raporti i vlerësimit të specifikacioneve teknike
1.1.3. Vlerësimi i përputhshmërisë teknike të SISH aktual me modulën e sistemit të referimit dhe të caktimit të termineve të synuar	TM1 2024	30.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASH, SP Pejë, QKMF Istog, IHS	Raporti i vlerësimit të përputhshmërisë teknike
Aktiviteti 2	Afati i zbatimit	Kostoja totale		Burim i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2				

2.1. Hapat teknik të dizajnit, zhvillimit dhe vlerësimit të modulit të sistemit elektronik të referimit dhe sistemit të caktimit të termineve	TM1-TM2 2024	120.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASH, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog IHS	Moduli i sistemit të referimit dhe caktimit të termineve funksional
Nën aktivitetet							
2.1.1. Sigurimi i nevojave pas gjetjeve nga vlerësimi i përputhshmërisë teknike (pajisjeve hardverike dhe të tjera)	TM1-TM2 2024	40.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, SP Pejë, QKMF Istog, IHS, Komuna e Istogut	Pajisjet hardverike dhe të tjera të siguruar
2.1.2. Zhvillimi i modulit të referimit dhe caktimit të termineve	TM2 2024	30.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, IHS, ASH, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Moduli i referimit dhe caktimit të termineve i zhvilluar
2.1.3. Instalimi dhe konfigurimi i modulit	TM3 2024	30.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, IHS, ASH, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Moduli i konfiguruar dhe i instaluar
2.1.4. Testimi i Modulit	TM3 2024	20.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, IHS, ASH, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Moduli i testuar
Aktiviteti 3	Afati i zbatimit	Kostoja totale		Burim i i financimit	Inst. udhëh eqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2				

3.1. Hartimi i udhëzuesit të përdorimit të modulit dhe Trajnimi	TM3 2024	40.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Programi i trajnimit dhe dhe udhëzuesi i hartuar
Nën aktivitetet							
3.1.1. Hartimi i Udhëzuesit të përdorimit të modulit	TM3 2024	5.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Udhëzuesi për përdorimin e modulit i hartuar
3.1.2. Hartimi i Procedurës Standarde operative për përdorimin e modulit.	TM3 2024	5.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Profesionistët shëndetësor dhe administratorët e SISH të trajnuar
3.1.3. Trajnimi i profesionistëve shëndetësor, administratorëve të SISH në SP Pejë dhe QKMF Istog	TM3 2024	30.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASH, IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Procedura standarde operative e hartuar dhe aprovuar
Aktiviteti 4	Afati i zbatimit	Kostoja totale		Burim i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2				
4.1. Pilotimi i sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve	TM4 2024	88.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASH, IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Raporti me të gjeturat pas pilotimit
Nën aktivitetet							
4.1.1. Organizimi i takimeve çdo dy javë me menagjmentin e lartë në ShSKUK, SP Pejë dhe QKMF Istog	TM4 2024	10.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASH, IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Procesverbalet dhe listat e pjesëmarrjes pas takimeve

4.1.2. Organizimi i fushatave sensibilizuese përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve, broshurave dhe materialeve të tjera të komunikimit (përfshirë materialin për video mesazhe-spote vetëdijësuese) në mediat lokale.	TM4 2024	30.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASHI,IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Fushatat sensibilizuese të realizuara
4.1.3. Organizimi i tryezave të rrumbullakta me palët e interesit (qytetarë, shoqëria civile, profesionistë shëndetësor)	TM4 2024	8.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASHI,IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Katër tryeza të rrumbullakta të organizuara
4.1.4. Implementimi dhe dokumentimi i pilotimit në SP Pejë dhe QKMF Istog	TM4 2024	40.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASHI,IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Raporti pas përfundimit të pilotimit
Aktiviteti 5	Afati i zbatimit	Kostoja totale		Burim i i financ imit	Inst. udhëh eqës	Inst. mbështetës	Produkti
		Viti 1	Viti 2				
5.1. Monitorimi, vlerësimi dhe mirëmbajtja	TM4 2024	30.000 €		BK, ShSK UK	MSh	SP Pejë, QKMF Istog, IHS	Raportet e monitorimit, vlerësimit dhe mirëmbajtjes
Nën aktivitetet							
5.1.1. Anketimi, intervistimi i përdoruesve të sistemit elektronik të referimit	TM4 2024	5.000 €		IHS	MSh	SP Pejë, QKMF Istog, IHS	Raporti pas anketimit, intervistimit të përdoruesve të sistemit elektronik të referimit
5.1.2. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave pas anketimit dhe intervistimit	TM4 2024	5.000 €		IHS	MSh	ShSKUK, ASHI,IHS, SP Pejë, QKMF Istog, Komuna Istog	Raporti me të dhënat e mbledhura dhe analizuara pas anketimit dhe intervistimit

5.1.3. Vizitat në terren për monitorim të procesit të pilotimit	TM2-TM4 2023	10.000 €		IHS	MSh	SP Pejë, QKMF Istog, IHS	Gjashtë vizita të realizuara për monitorim të procesit të pilotimit dhe raportet e dorëzuara
5.1.4. Mirëmbajtja e sistemit elektronik të referimit dhe caktimit të termineve	TM4 2023	10.000 €		IHS	MSh	SP Pejë, QKMF Istog, IHS	Raportet mujore të procesit të mirëmbajtjes
Totali: 328.000.00 €							